



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 261/2019

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevci kryesues, Ferki Xhaferi dhe Faton Ademi anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtarit të lartë ligjore Kudret Hasani, duke vendosur lidhur me ankesat e Organizatës Joqeveritare BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA me seli në Prishtinë, si dhe te subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, të paraqitura ndaj subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës të datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 06.10.2019, mori këtë:

### V E N D I M

**Refuzohen** te pabazuar ankesat: Anr.261/2019, Anr. 269/2019, dhe Anr.278/2019, te gjitha te datës 05.10.2019, te paraqitura nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA, si dhe nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, për shkak të vazhdimit të sponsorimit e fushatës zgjedhore në rrjetin social “Facebook”, edhe në ditën e heshtjes zgjedhore.

### A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar ankesat: Anr.261/2019, Anr. 269/2019, dhe Anr.278/2019, te gjitha te datës 05.10.2019, te paraqitura nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA, si dhe nga subjekti politik PDK, të paraqitura kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me të cilat kanë pretenduar, se me datë 05.10.2019, gjatë ditës së heshtjes zgjedhore, kandidatët për deputet te paraqitur në ankesat e lartcekura, kanë vazhduar sponsorimin e fushatës zgjedhore në “Facebook”, edhe në ditën e heshtjes zgjedhore. Më këtë rast pretendohet se është bërë thyerje e heshtjes zgjedhore, të përcaktuar me LZP. Me propozim për PZAP-in, që ankesat të pranohen si të bazuar.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmerisë së ankesave dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, provave materiale - fotografive të bashkangjitur, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

**Ankesat janë të pabazuar**, për këto arsye:

Paneli paraprakisht ka vlerësuar se ankesat: Anr.261/2019, Anr. 269/2019, dhe Anr.278/2019, te gjitha te datës 05.10.2019, janë për nga përmbajtja të njëjta, për nga natyra e shkeljes së pretenduar janë të njëjta, janë paraqitur kundër subjektit të njëjtë politik, prandaj paneli

bazuar në nenin 8 paragrafi 3 i Rregullave dhe Procedurave Nr.02/2015, të PZAP-it, në të cilën përcaktohet se: *Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të ankesave kryesuesi i panelit vend marrës mund të vendos ta bëjë bashkimin e ankesave që përmbajnë në vete çështje të ngjashme dhe se ato ankesa të trajtohen me një vendim*", andaj paneli bëri bashkimin e ankesave dhe për të njëjtat vendosi me një vendim, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli vlerëson se parashtruesit e ankesave në mbështetje të pretendimeve për ankesat, nuk kane ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse edhe pse barra e te provuarit bie mbi ankuesin, në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, për te provuar se shkelësit e supozuar e kanë vazhduar sponsorimin e fushatës zgjedhore edhe në ditën e heshtjes zgjedhore me datë 05.10.2019.

Nga provat e ofruar nga ankuesi, nuk mund të vërtetohet në mënyrë bindëse dhe të qartë se reklamat e shkelësve të supozuar janë publikuar apo kanë vazhduar sponsorimet e fushatës zgjedhore edhe në ditën e heshtjes zgjedhore, sepse me asnjë provë shkresore nuk është argumentuar data dhe ora e reklamave të shkelësve të supozuar që pretendohet, se janë publikuar apo kanë vazhduar sponsorimet e fushatës zgjedhore edhe në ditën e heshtjes zgjedhore.

Ditën e shqyrtimit të këtyre ankesave, paneli ka hetuar nëse sponsorizimet e supozuara janë aktive por qe nuk ka qenë e mundur te vërtetohet në rrugë elektronike nëse te njëjtat një ditë me parë kanë qenë aktive dhe në kohën e testimi të njëjtat kane qene jo aktive.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr.261/2019 më datën 06.10.2019

Kryesuesi i Panelit

Adnan Konushevc



**Këshillë juridike:** *Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, në kuptim të nenit 118 paragrafi 4 i LZP-së.*